



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KRYETARI

Nr. 86 prot.

Himarë, më 09.01.2023

VENDIM

Nr. 2, datë 09.01.2023

PËR

PLANIN VJETOR TË PRANIMEVE NË SHËRBIMIN CIVIL, PËR VITIN 2023

Në zbatim të nenit 18, pika 2, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, vendimit nr. 108, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil", vendimit nr. 1, datë 05.01.2023 të Kryetarit të Bashkisë Himarë "Për miratimin e strukturës së Bashkisë Himarë për vitin 2023",

VENDOSA :

1. Miratimin e planit vjetor të pranimeve në shërbim civil për vitin 2023 sipas listës së më poshtme të pozicioneve me kategoritë, klasat dhe grupet përkatëse të administrimit.

Nr. Rendor	Kategoria	Numri i vendeve vakante	Klasa	Kategoria e pagës
	Nëpunës civil i kategorisë së ulët drejtues			
1	Përgjegjës sektori, në sektorin e burimeve njerëzore dhe informacionit	1 (një)	III	III-a/1
2	Përgjegjës sektori, në sektorin e shërbimeve dixhitale	1 (një)	III	III-a/1
3	Përgjegjës sektori, në sektorin e menaxhimit të aseteve	1 (një)	III	III-a/1
4	Përgjegjës sektori, në sektorin e prokurimeve dhe procedurave administrative	1 (një)	III	III-a/1
5	Përgjegjës sektori, në sektorin e administrimit të të ardhurave dhe statistikave	1 (një)	III	III-a/1
6	Përgjegjës sektori, në sektorin e vlerësimit dhe kontrollit të të ardhurave	1 (një)	III	III-a/1

7	Përgjegjës sektori, në sektorin e shërbimeve publike dhe mirëmbajtjes	1 (një)	III	III-a/1
	Nëpunës civil të kategorisë ekzekutive			
8	Specialist auditues i brendshëm	2 (dy)	IV	IV-A
9	Specialist i arsimit dhe rinisë	1 (një)	IV	IV-A
10	Specialist për mbrojtjen e fëmijëve	1 (një)	IV	IV-A
11	Specialist i kulturës	1 (një)	IV	IV-A
12	Specialist i buxhetit	1 (një)	IV	IV-A
13	Specialistit i performancës së shërbimeve	1 (një)	IV	IV-A
14	Specialist i informimit dhe komunikimit për BE-në	1 (një)	IV	IV-A
15	Specialist i statistikave dhe i borxhit	1 (një)	IV	IV-A
16	Inspektor kontabilizimi dhe verifikimi të biznesit	1 (një)	IV	IV-A
17	Inspektor regjistrimi dhe verifikimi të biznesit	1 (një)	IV	IV-A
18	Specialist për kontrollin e zbatimit të ndërtimeve	1 (një)	IV	IV-A
19	Specialist inxhinier mjedisi	1 (një)	IV	IV-A
20	Specialist gjeodet	1 (një)	IV	IV-A

- Ngarkohet drejtorja e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse për publikimin e këtij plani në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në faqen zyrtare të Bashkisë Himarë dhe në këndet e publikimeve në Bashkinë Himarë dhe në dy njësitë administrative Horë – Vranisht dhe Lukovë.
- Ngarkohet drejtorja e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse të fillojë kryerjen e procedurave të rekrutimit pas publikimit të këtij plani pranimesh.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Jorgo Goro

